Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0605

Organi Shqyrtues i Prokurimit përmes Panelit Shqyrtues në përbërje të Vedat Poterqoi - Kryetar, Vjosa Gradinaj Mexhuani - Anëtare dhe Isa Hasani - Anëtar, duke vendosur mbi ankesën e operatorit ekonomik "DOCTOR EXTERMINATOR DDD" SH.P.K., me Nr.605/23 të datës 22.08.2023 si dhe ankesën e operatorit ekonomik "S.V.Veterina" me Nr.612/23 të datës 24.08.2023 kundër Vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit të Autoritetit Kontraktues - POLICIA E KOSOVËSlidhur me aktivitetin e prokurimit "Shërbime të Dezinfektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit në objektet Policore" me numër të prokurimit 214-22-5200-2-1-1, në bazë të nenit 105 lidhur me nenin 106 dhe nenin 117 të LPP, me datë 01.12.2023merr këtë:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K., me nr. 605/23 e datës 22.08.2023 Vendimi për anulimin e procedurës së prokurimittë Autoritetit Kontraktues - POLICIA E KOSOVËS për aktivitetin e prokurimit me titull "Shërbime të Dezinfektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit në objektet Policore" me numër të prokurimit 214-22-5200-2-1-1, anulohet, ndërsa aktiviteti kthehet në ri-vlerësim.

2. Aprovohet, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "S.V.Veterina," me nr. 612/23 e datës 24.08.2023, Vendimi për anulimin e procedurës së prokurimit të Autoritetit Kontraktues - POLICIA E KOSOVËS për aktivitetin e prokurimit me titull "Shërbime të Dezinfektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit në objektet Policore" me numër të prokurimit 214-22-5200-2-1-1, anulohet, ndërsa aktiviteti kthehet në ri-vlerësim.

3. Lejohet kthimi i shumës së deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës dhe obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 10.06.2023, Policia e Kosovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Shërbime të Dezinfektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit në objektet Policore" me numër të prokurimit 214-22-5200-2-1-1. Ndërsa me datën 10.08.2023ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 përmes të cilit ka anuluar aktivitetin e prokurimit.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbime dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 379,614.27 €.

Me 11.08.2023, OE "DOCTOR EXTERMINATOR DDD" SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues. Me datë 15.08.2023 po ashtu edhe OE "S.V.Veterina" ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues.

Me 15.08.2023, Autoriteti Kontraktues ka publikuar refuzuar kërkesat për rishqyrtim të operatoreve ekonomik ankues si të pa bazuara.

Me 22.08.2023, OE DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K., ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 605/23 ndërsa me datë 24.08.2023 OE "S.V. Veterina"ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 612/23.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesave, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se të dy ankesat i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si të tilla janë parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatorët ekonomik që janë palë të interesuara sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këto ankesa sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesave në mënyrë meritore.

Duke marrë parasysh faktin se të dy ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa NR. 605/23 dhe ankesa NR. 612/23 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues **"**DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K.", janë parashtruar si në vijim**:**

Ankuesi pretendon se"*Ne si OE ankues kemi pasur leje të përdorimit të sulfurit me 28 %, deri me datën 21.06.2023, të lëshuar nga MMPHI, ku edhe jemi shpallur fitues të këtij tenderi, po ashtu arsyetimi i AK, bije në kundërshtim me arsyetimin e vendimit të OSHP-së, për arsye sepse OSHP, thotë që sulfuri është i ndaluar, kurse AK, thotë që sulfuri me 28 % është i ndaluar, gjë që të dy e kanë gabim edhe AK edhe OSHP, për arsye se gjatë gjithë kësaj kohe ne si OE ankues kemi poseduar lejen për sulfur, përkatësisht produkt për repelent me përbërje të sulfurit dhe për këtë është bërë importi i produktit, (Vendim për leje të importit nga MMPH.Nr.22/2940/-1-ZSP/411/22 Datë 15.06.2022), vlen të ceket se në bazë të këtij vendimi për leje të importit edhe është bërë importimi i produktin me të cilin edhe kemi fituar tenderin, kurse leja e importit ka qenë valide deri me datën 21.06.2023, kurse tenderi është fituar brenda kohës së vlefshmërisë së lejes së importit (dt.27.04.2023 shpallemi fitues), po ashtu AK fillimisht edhe dashur te bashkëngjit dokumentin zyrtar të komunikimit me ministrinë përkatëse, po ashtu edhe si OE Fitues, Autoritetit Kontraktues ju kemi drejtuar me email me dt.10.08.2023, për të kërkuar dëshminë me shkrim nga ministria përkatëse se kinse sulfuri nuk mund të përdoret në lëmin e DDD-së, mirëpo deri në ditën e parashtrimit të ankesës jemi pa përgjigje lidhur me kërkesën tonë pra AK. Sipas të dhënave të cilat janë shumë lehtë të verifikueshme po ashtu bazuar në atë se ECHA (Agjencia Europiane Kimikale), asnjëherë nuk e ka ndaluar përdorimin e sulfurit për lëminë e DDD-së, por edhe në Kosovë një gjë e tillë nuk është ndaluar këtë më së miri e konstaton dokumenti "Material Safety Data Sheet" që OE ankues tani posedon edhe me vazhdimin e lejes së përdorimit të sulfurit, që është i regjistruar nga ne, para se të merr vendim AK dhe OSHP, që do të thotë se sulfuri nuk ka qenë i ndaluar asnjëherë dhe as sasia e tij e cila tani sipas lejes së re është 10 %. Me tutje mbështetur në nenin 52 paragrafi 1.4 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përcaktohet se akti administrativ është i paligjshëm nëse: "është nxjerr në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ", gjë që vendimi i dt.15.08.2023, konform këtyre dispozitave është në tërësi i paligjshëm, pasi që nuk ekziston asnjë rrethanë apo provë që dëshmon se sulfuri është produkt i ndaluar, përkundrazi ekzistojnë dëmshmi se ky produkt pikërisht është i lejuar e këtë fakt nuk e ka vërtetur AK.*

Duke u referuar pretendimeve si më sipër, Ankuesi "DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 4, 6, 7, 9, 10, 13 të LPP si dhe nenin 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative duke kërkuar nga Paneli Shqyrtues në OSHP që të aprovohet ankesa si e bazuar dhe aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "S.V,Veterina", janë parashtruar si në vijim:

Ankuesi pretendon se *"AK me datën 24.07.2023 ka pranuar Vendimin e OSHP nr. 2023/0283 ku është pranuar ankesa jone si e bazuar dhe është obliguar AK te na kërkoj sqarime ne pajtim me nenin 72 te LPP-se, dhe nga ajo date kur AK ka pranuar vendimin e OSHP ne fjale nuk na është drejtuar me shkresa zyrtare duke na kërkuar sqarime ashtu siç ka obliguar vendimi i OSHP, duke shkelur vendimin ne fjale dhe duke na diskriminuar, duke mos na trajtuar si palë me interes ne këtë AP , edhe për kundër se kemi tenderuar me çmimin me te lire dhe kemi plotësuar te gjitha kriteret e përzgjedhjes, si dhe kemi tenderuar ne pajtim te plote me nenin 28 te LPP-se konkretisht Aneksin 1 te FDT-se, duke tenderuar dhe duke prezantuar katalogun e produkteve me te cilat do te ekzekutohet behët DDD ne pajtim me karakteristikat mjedisore, standardeve Evropiane (ne pajtim me miratimin teknik Evropian) dhe ne pajtim te plote te standardeve ndërkombëtare, po ashtu edhe në pajtim me standardet e Republikës se Kosovës te cilat janë te harmonizuar me Direktiva te BE-se dhe licencave te cilat kërkohen për importin e preparateve për DDD si nga MMPH dhe nga MNPZHR te cilat e rregullojnë fushën e DDD në Republikën e Kosovës. AK nuk ka respektuar Vendimin e OSHP nr. 2023/0283 te datës: 24.07.20203, për faktin sepse ky vendim e Obligon AK qe gjate faze se Ri-vlerësimit të bëjë hulumtimin e këtyre preparateve me substanca aktive te ngritura në pretendimet ankimore të OE ankues FLOMED SHPK, dhe pas një konstatimi te SAKTE, nëse këto preparate janë te lejuara atëherë të filloj ta bëjë RI-vlerësimin e ofertave në të kundërtën ta anulojë AP.AK ka shkelur vendimin e OSHP nr. 2023/0283 te datës 24.07.2023, për faktin se PSH e ka obliguar AK te na kërkoj sqarime ne pajtim me nenin 72 te LPP-së, mirëpo AK vepruar ne kundërshtim me Vendimin ne fjali pasi qe nuk ka kërkuar sqarim fare. Ky aktivitet i prokurimit është anuluar ne kundërshtim me nenin 59 dhe 62 te LPP-së, për faktin se OE FLOMED SHPK është palë pa interes sipas nenin 4 par. 1.26 të LPP-së, për faktin se nga data e njoftimit për kontrate te datës: 10.06.2022 (kur është publikuar ne platformën elektronike e-prokurim), OE FLOMED SHPK asnjëherë nuk ka kërkuar sqarime shtesë sipas nenit 53 te LPP-së, si dhe as Kërkesë për Rishqyrtim sipas nenit 108/A te LPP-së (Prove: Platforma elektronike), mirëpo vetëm pas tenderimit – procesverbalit te hapjes i cili është radhitur si tenderuesi me numër rendorë 6 (gjashtë) nga gjithsejtë 7 (shtatë) tenderues/ofertues ne këtë aktivitet te prokurimit, që do të thotë se fillimisht PSH është vënë ne lajthitje nga Eksperti TEKNIK i jashtëm.Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së. Gjithashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-se, sepse ne jemi diskriminuar duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar te gjitha kërkesat e FDT-se dhe te njoftimit për kontrate."*

Duke u referuar pretendimeve si më sipër, Ankuesi S.V.Veterina, konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 2, 6, 7, 24, 52, 59, 62, 66, 67 dhe 72 të LPP dhe nenin 41 dhe 47 të RRUOPP-së si dhe nenin 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative duke kërkuar nga Paneli Shqyrtues në OSHP që të aprovohet ankesa si e bazuar dhe aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 01.09.2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 605/23 ndërsa me datë 29.08.2023 Paneli Shqyrtues ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 612/23.

Lidhur me ankesën nr. 605/23 me datë 11.09.2023 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2023/0605 me rekomandimet si në vijim: "*ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.*"

Lidhur me ankesën nr. 612/23 me datë 11.09.2023 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me Nr. 2023/0612 me rekomandimet si në vijim: "*ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.*"

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK pajtohet me me rekomandimet e ekspertit. OE "DOCTOR EXTERMINATOR DDD " SH.P.K. ka deklaruar se nuk pajtohet me rekomandimet në raportin e ekspertit shqyrtues duke theksuar *"për shkak se AK, ka bere anulimin e tenderit kinse për shkak se kemi produkte biocide te palejuara, kurse eksperti shqyrtues nuk ka marr për baze ankesën dhe faktet se këto produkte biocide janë te lejuara, por është marre me afate te lejeve te përdorimit te tyre dhe sasisë se tyre, qe është e gabuar, sepse organet kompetente kane lëshuar leje për këto produkte dhe ne kohen e fitimit te tenderit ka pasur leje edhe për sasi me te madhe te sulfurit, kurse tani ne mënyrë retroaktive jepen mendime për kinse ndalimin e tyre qe është e gabuar dhe cenon rende parimin e sigurisë juridike."* Edhe OE "S.V.Veterina, ka deklaruar se pajtohet me rekomandimet në raportin e ekspertit shqyrtues duke theksuar "*ESH nuk është përgjigjur ne pretendimet tona ankimore as ne dispozita te shkelura dhe as deklaratën detale te fakteve dhe argumenteve. ESH e pranon se specifikacioni teknik është ne harmoni me nenin 28 te LPP-se, kurse ESH ja huq tërësisht sepse ne nuk kemi dorëzuar "Safety Data Sheet" askund ne oferte, por thirret ne pretendimet e OE i cili ka hedhe pretendime ne ankesën e tije e ku ne kemi prova dhe fakte disa Vendime te OSHP qe ne këto raste OE janë pale pa interes sepse ne këto raste OE kane qellim vetëm te anulojnë procedurat e prokurimit sepse janë pale pa interes sipas nenit 4 par. 1.26 te LPP-se..."*

Lidhur me lëndën 605/23 dhe 612/23 është mbajtur seance me datën 17.11.2023, ku ishin te pranishëm paneli shqyrtues, eksperti shqyrtues si dhe përfaqësuesit e OE ankueseve.

Përfaqësuesi i OE 'DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K.", përmes parashtresës nder të tjera ka deklaruar si "Ne si OE ankues qëndrojmë në tërësi pranë ankesës së parashtruar me dt. 22.08.2023, pasi që ritheksojmë se Vendimi i dt. 15.08.2023 nga AK Policia e Kosovës –

Departamenti i Prokurimit i cili anulon në tërësi procesin e prokurimit me nr: prok: 214-22-5200-2-1-1, nr. i brendshëm 214/22/078/211, sa i përket tenderit për "Shërbime të Dezinfektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit në Objektet Policore ri-vlerësim", është proces jo i rregullt për shkak se është marr në shkelje të dispozitave ligjore dhe atë nenin 1, 4, 6, 7, 9 dhe 10 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik. Po ashtu edhe nenin 13, 47 par.3, 48 par.1 pika 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, 1.6, si dhe par. 2 të nenit 48 të Ligji Nr. 05/L -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative. OE Ankues ka të drejtë lidhur me pretendimet e ngritura, që të gjitha këto pretendime në një analizë të mirëfillte të provave dhe bazës ligjore dëshmojnë shkeljet e bëra nga AK dhe domosdoshmerinë e anulimit të vendimit të AK."

Përfaqësuesi i OE 'S.V.Veterina", ka deklaruar nder të tjera se "ne qëndrojmë në pretendimet tona ankimore sikurse në ankesën tonë pranë OSHP, ku AK ka shkelur dispozitat ligjore sikurse kemi theksuar ne ankesën tonë tek Dispozitat e shkelura nga AK, pasi që AK me datën 24.07.2023 ka pranuar Vendimin e OSHP nr. 2023/0283 ku është pranuar ankesa jonë si e bazuar dhe është obliguar AK te na kërkoj sqarime në pajtim me nenin 72 të LPP-së, dhe nga ajo datë kur AK ka pranuar vendimin e OSHP ne fjalë nuk na është drejtuar me shkresa zyrtare duke na kërkuar sqarime ashtu siç ka obliguar vendimi i OSHP, duke shkelur vendimin dhe duke na diskriminuar, duke mos na trajtuar si palë me interes në këtë AP, edhe për kundër se kemi tenderuar me çmimin më të lirë dhe kemi plotësuar të gjitha kriteret e përzgjedhjes, si dhe kemi tenderuar në pajtim të plotë me nenin 28 të LPP-së konkretisht Aneksin 1 të FDT-së, duke tenderuar dhe duke prezantuar katalogun e produkteve me të cilat do të ekzekutohet behet DDD në pajtim me karakteristikat mjedisore, standardeve Evropiane (në pajtim me miratimin teknik Evropian) dhe në pajtim të plotë të standardeve ndërkombëtare, po ashtu edhen pajtim me standardet e Republikës se Kosovës të cilat janë të harmonizuar me Direktiva të BE-së dhe licencave të cilat kërkohen për importin e preparateve për DDD si nga MMPH dhe nga MBPZHR të cilat e rregullojnë fushën e DDD ne Republikën e Kosovës."

Përfaqësuesi i AK ka deklaruar "Sipas vendimit të OSHP-së me numër 2023/0283 i datës 24/07/2023 AK Policia e Kosovës për aktivitetin e prokurimit me titull "Shërbime të Dezinfektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit në Objektet Policore" me numër te prokurimit 214-22-5200-2-1-1 & 214/22/078/211 ka ndërmarr veprime ne përputhje me ketë vendim ku fillimisht pas krijimit te komisionit te ri-vlerësimit kemi filluar komunikimet me zyrtarët përgjegjës te MMPH-së ku kemi mbajtur edhe takim dhe na është shpjeguar se kanë ndryshuar rregulloret e BE mbi përdorimin e preparateve me substanca primare Sulfurin dhe me rregulloren e re sulfuri nuk lejohet te jetë substancë primare por munde të jetë substance përbërëse e fundit me maksimum prej 10.0% këto i gjeni në shkresat e bashkangjitura dhe mbi ketë baze AK ka bërë anulimin e aktivitetit te prokurimit pasi produktet e ofruar nga kompanitë ofertuese kanë pasur substancë primare sulfurin dhe ri-vlerësimi ka qen i pamundur pasi nuk do ishin trajtuar te gjitha OE njësoj dhe si rrjedhojë do te kishim shkelje te nenit 7 dhe 59 te LPP. Vlen te theksohet se te gjithë OE lejet e importi ju kanë skaduar ne lejet e importit te produkteve dhe si rrjedhoje asnjë OE nuk mund të importojë preparate me substancë primare Sulfurin me të cilat edhe kanë ofertuar. Sipas standardeve te BE nuk lejohet përdorimi i preparateve me substancë primare Sulfer pasi janë rrezik për shëndetin Publik.

Lidhur me këtë Paneli shqyrtues ju drejtu AK se Dosja e Tenderit të cilën e kanë shpallur a përmban ndonjë specifik e cila bie ndesh me rregullat në fuqi dhe rregulloret evropiane, për shkak se palët kanë deklaruar në ankesat e tyre se paneli shqyrtues në vendimin paraprak ka rënë në lajthitje të ekspertit teknik, AK u deklarua se Dosja e Tenderit nuk përmban asnjë specifik e cila është e ndaluar, këtë e konfirmuan edhe palët tjera, përveç kësaj u deklarua që edhe po të ri-shpalles do të publikohej Dosja e Tenderit e njëjtë. Këtë detyre e ka pas AK me vendimet paraprake ta sqaroj.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportet e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportet e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesve, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE "DOCTOR EXTERMINATOR DDD" SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0605 ka vlerësuar si në vijim:

Eksperti ka sqaruar se për këtë aktivitet te prokurimit është shpallur fitues OE Doctor Exterminator me datën 27.04.2023. Pas ankesës ne OSHP të disa OE pjesëmarrës të aktivitetit të prokurimit është marr vendim nga PSH me nr. 2023/283. AK-ja pas sqarimeve të marra nga MMPH ka anuluar aktivitetin e prokurimit në tërësi.

Lidhur me pretendimin e OE ankues qe ka te beje me importin e produktit te sulfurit dhe vendimin e AK-se për anulimin e aktivitetit te prokurimit eksperti shqyrtues sqaron se kërkesë te dosjes se tenderit është: **<u>Largimi i zvarranikëve</u>** – Për kryerjen e këtij shërbimi të përdoret njëri lloj i këtyre aparateve apo vetëm granulat.

1 - Aparate me vibrim për dëbimin e zvarranikëve me bateri që vendosen në tokë.

- Sipërfaqja 300 - 400 m² për largimin e Zvarranikeve, të qëndrueshëm ndaj lagështisë. ose

2 –Aparate solare me vibrim për dëbimin e zvarranikëve që vendosen në tokë.

- Sipërfaqja 600 – 700 m² për largimin e Zvarranikëve të qëndrueshëm ndaj lagështisë.

3 – Preparate repelente ekologjike si granula për largimin e zvarranikëve me efektivitet optimal.

Për çështje të sigurisë së tyre në lidhje me origjinën e produkteve tenderuese dhe lejen për përdorim në RK, duhet të paraqesë edhe lejen e importit të produkteve të lëshuar nga Ministria e Ambientit Hapësinor në RK.

Sa i përket pjesës se pretendimit të OE ankues që ka të bëjë me importin e produkteve biocide dhe sqarimit se a janë te ndaluara produktet sipas listës se zyrtareve te MMPH eksperti shqyrtues vlerëson se zyrtarët e AK-së kanë sqaruar përmes komunikimit zyrtar me zyrtaret e MMPH se produktet sipas "Material Safety Data Sheet" me nr ID 875-25b kane ndryshuar ne përmbajtje te komponentëve te rrezikshme dhe se përqindjet e lejuara tani janë dukshëm me te ultë se me lejen e importit qe OE pjesëmarrës te aktivitetit te prokurimit kanë në posedim. OE ankues ne ofertën e tij ka ofruar produkt me përmbajtje te sulfurit 28% derisa me rregullat e sqaruara me larte kjo përmbajtje ka rene ne 10%.

Vlen te theksohet se ne dosje te tenderit nuk është kërkuar përmbajtja e produkteve apo "Safety Data Sheet" për produktet e ofruara nga OE pjesëmarrës ne aktivitet te prokurimit. Eksperti shqyrtues pas administrimit te provave, dosjes se tenderit, ankesat e OE qe nga inicimi i aktivitetit te prokurimit, vendimeve te PSH vlerëson se është me rëndësi qe të shpalosen edhe fakti se ky aktivitet i prokurimit është shpallur me 10.06.2022. Nga kjo periudhë ka pas ndryshime ne rregulloret e aplikuara për produktet qe përdoren nga OE-te pjesë e aktivitetit te prokurimit. Duke pas parasysh përmbajtjet e produkteve dhe rrezikshmërinë e tyre për shëndetin publik eksperti shqyrtues e potencon faktin se OE pjesëmarrës ne këtë aktivitet te prokurimit është kërkuar qe të posedojnë licencë për importin e këtyre produkteve. Por, duke u bazuar ne faktin se ka kaluar një kohë relativisht e gjatë dhe se OE pjesë të aktivitetit të prokurimit të gjithë posedojnë një apo të gjitha licencat e skaduara dhe sqarimet e zyrtarit te MMPH se përmbajtja e produkteve biocide pjesë e licencës do të ndryshojë në përputhje me rregulloret e reja në fuqi dhe se çdo licencim do te behet me rregulla qe kanë ndryshuar eksperti shqyrtues vlerëson se AK më të drejtë ka vlerësuar se vjen ne shprehje shëndeti publik dhe se çdo rivlerësim i ofertave ne këtë fazë nuk do të mund të bëhet në përputhje me LPP-
në Neni 7 Ba a ia në aj im/ J Di k imi i i, Neni 59 k amini i, le ë imi d e K a a imi i en e ë e, si dhe RRPP 001/2022 Neni 4 Administrimi i përgjithshëm i procedurave të prokurimit. Vazhdimi i lejes se importit e cila tani ne përmbajtje ndryshon dukshëm bien ne kundërshtim me nenin 59 paragrafi 2 te LPP-
se Aut ite i o tra tu s u d t që e h m të ër o ë n a n ë t n er es ë të g o ë n ë q m e m bi do n a a e tet e te d t të t , në ë ë që të h t e a n , erë i o e a a i i te d ë e. n ë n h m at al he a n ë a e t i e erit n k d h t të ër o en ose o en n a tor eti o tra u s ose ë o en n a ë te erue .Po ashtu dorëzimi i vazhdimit te lejes se importit nga të gjithë OE pjesë të aktivitetit të prokurimit do te binte ndesh me nenin 72 paragrafi 3 i LPP-se Sigurimi i

informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do te aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e te cilave është e fiksuar, para skadimit te afatit për dorëzimin e tenderëve dhe mund te verifikohet ne mënyrë objektive.Si përfundim eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i OE ankues nuk është i bazuar.

Sipas të thënave më sipër, eksperti i kanë trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K.Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtues është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Për më tepër konstatimet e ekspertit janë të bazuara edhe në dispozitat përkatëse të LPP dhe RRPP. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues "DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K., i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Me këtë rast Paneli Shqyrtues ka marrë në konsideratë edhe përgjigjet e OE ankues lidhur me raportin e ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K., janë të pa bazuara**.**

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankuesS.V.Veterina, eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0612 ka vlerësuar se:

Lidhur me pretendimin e OE ankues qe ka te beje me sqarimet qe AK është e obliguar te bëjë për preparatet me substanca aktive dhe vendimit te PSH me nr. 2023/0283 eksperti shqyrtues sqaron se kërkesa e specifikimit teknik pjese dosjes se tenderit ka qenë: Largimi i zvarranikëve – Për kryerjen e këtij shërbimi të përdoret njëri lloj i këtyre aparateve apo vetëm granulat.

1 - Aparate me vibrim për dëbimin e zvarranikëve me bateri që vendosen në tokë.

- Sipërfaqja 300 - 400 m² për largimin e Zvarranikeve, të qëndrueshëm ndaj lagështisë. ose

2 –Aparate solare me vibrim për dëbimin e zvarranikëve që vendosen në tokë.

- Sipërfaqja 600 – 700 m² për largimin e Zvarranikëve të qëndrueshëm ndaj lagështisë.

3 – Preparate repelente ekologjike si granula për largimin e zvarranikëve me efektivitet optimal.

Për çështje të sigurisë së tyre në lidhje me origjinën e produkteve tenderuese dhe lejen për përdorim në RK, duhet të paraqesë edhe lejen e importit të produkteve të lëshuar nga Ministria e Ambientit Hapësinor në RK.

Pretendimi i OE ankues se AK-ja ka qenë e obliguar që të kërkojë sqarime nga OE pjesë e aktivitetit të prokurimit është pjesërisht i qëndrueshëm sepse vendimi i PSH e obligon të bëjë hulumtim te këtyre preparateve me substanca aktive te ngritura ne ankesën 2023/0283 por jo detyrimisht me OE pjesë të procedurës te cilën AK-ja e ka bërë me zyrtarët për produktet biocide pranë MMPH. Sa i përket pjesës se pretendimit ku OE ankues i referohet Aneksit 1 te dosjes se tenderit "Lejohet për përdorim edhe preparati ekuivalent me efekt te njëjtë" eksperti shqyrtues sqaron se pjesa e specifikimit teknik për "largimi i zvarranikeve" nuk e ka fjalinë te cilën i referohet OE ankues. Sidoqoftë të njëjtat janë bazuar ne LPP-në neni 28 paragrafi 7. Sa i përket pjesës se pretendimit se OE Flomed është palë pa interes sipas nenit 4 paragrafi 1.26 te LPP-se eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim nuk qëndron sepse para se ankesa te pranohet për shqyrtim i bëhet vlerësimi nëse OE ankues është palë me interes dhe pastaj shqyrtohet ankesa. Fakti qe ankesa e OE është shqyrtuar dhe vendosur nga PSH e vërteton se pala ankues është palë me interes sipas nenit 4 paragrafi 1.26 te LPP-se. Pretendimi i OE ankues qe ka te bëjë me preparatet e dorëzuara me ofertën e tij dhe arsyetimi se preparatet qe ka dorëzuar janë ekologjike bazuar ne katalogun e OE ankues DHE "*Funksioni është vetëm për të mbajtur zvarranikët (të tillë si gjarpërinjtë) larg zonës së trajtuar, pa qenë të dëmshëm për ta, mjedisin dhe kafshët e tjera*." Bazuar ne "Safety Data Sheet" i produktit te rrezikshmëria e produktit është i klasifikuar si H317 dhe H412 e cila me rregulloren Nr. 1272/2008 e Parlamentit Evropian e definon si "te dëmshëm për organizmat ujor me efekte te përhershme**"** Prandaj ky pretendim është pjesërisht i bazuar. Vlen te theksohet se ne dosje te tenderit nuk është kërkuar përmbajtja e produkteve apo "Safety Data Sheet" për produktet e ofruara nga OE pjesëmarrës ne aktivitet te prokurimit. Sa i përket pretendimit ankimor te OE ankues qe ka te bëjë me pjesën ku i referohet preparatit te sulfurit dhe deklaratës se i njëjti lejohet deri ne 28% nuk qëndron sepse kjo është sqaruar përmes komunikimit te AK-se dhe zyrtareve te MMPH ku n baze te rregullës se re përmbajtja e sulfurit nuk është e lejuar me përqindjen si me lartë. Vlen te ceket se OE ankues ne pretendimin e tij cek *"pasi qe ne sigurojmë AK se preparate tona ashtu siç kemi prezantuar ne katalog por edhe me rastin e përdorimit dot e prezantojmë Safety data Sheet dhe licenca për importin e tyre"* Eksperti shqyrtues pas administrimit te provave, dosjes se tenderit, ankesat e OE qe nga inicimi i aktivitetit te prokurimit, vendimeve te PSH vlerëson se është me rëndësi qe të shpalosen edhe fakti se ky aktivitet i prokurimit është shpallur me 10.06.2022. Nga kjo periudhe ka pas ndryshime ne rregulloret e aplikuara për produktet qe përdoren nga OE-te pjesë e aktivitetit te prokurimit. AK-ja ju ka drejtuar MMPH me kërkesën për sqarimin për mbi importin e produkteve biocide te cilën zyrtari për produkte biocide e sqaron përmes listës teknike te sigurisë ku janë te specifikuara edhe përqindjet e lejuara për import. Nga lista shihet se përqindjet kane ndryshuar dhe përmbajtja e lejuar tani është dukshëm me e vogël se me parë. Duke pas parasysh përmbajtjet e produkteve dhe rrezikshmërinë e tyre për shëndetin publik eksperti shqyrtues e potencon faktin se OE pjesëmarrës ne këtë aktivitet te prokurimit posedojnë licencë për importin e këtyre produkteve. Por duke u bazuar ne faktin se ka kaluar një kohë relativisht e gjatë dhe se OE pjesë të aktivitetit të prokurimit të gjithë posedojnë një apo të gjitha licencat e skaduara dhe sqarimet e zyrtarit te MMPH se përmbajtja e produkteve biocide pjesë e

licencës do të ndryshojë në përputhje me rregulloret e reja në fuqi dhe se çdo licencim do të bëhet me rregulla te ndryshuara si dhe çdo plotësim i dokumenteve me rastin e licencimit te serishëm te OE-ve në këtë fazë të aktivitetit te prokurimit do te bëhej ne kundërshtim me nenin Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtese paragrafi 3 i LPP-së eksperti shqyrtues vlerëson se AK më të drejtë ka vlerësuar se vjen ne shprehje shëndeti publik dhe se çdo rivlerësim i ofertave ne këtë fazë nuk do të mund të bëhet në përputhje me LPP-në Neni 7 Ba a ia në aj im/ J Di k imi i i, Neni 59 k amini i, le ë imi d e K a a imi i en e ë e, si dhe RRPP 001/2022 Neni 4 Administrimi i përgjithshëm i procedurave të prokurimit.

- Konstatimi i Panelit Shqyrtues –

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, sikurse kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, prandaj analizoi në vijim të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se ka nevojë të caktohet seanca publike me palë mbajtur me 17.11.2023 sikurse parashihet me paragrafin 2, të nenit 24 të Rregullores së cituar, me qëllim të shqyrtimit objektiv dhe të drejtë të çështjes. Në ketë rast (në zbatim të parimit kontradiktor) janë analizuar pretendimet ankimore, veprimet dhe aktet e AK, përfshirë dhe shpjegimet e ekspertit shqyrtues dhe të gjitha krahas administrimit të gjithmbarshëm të provave dhe atyre të sjellura në seancën ndëgjimore nga të dyja palët, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e palëve në proces, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij nuk janë të pranueshme nga ana e këtij Paneli, për shkak se eksperti shqyrtues nuk ju ka përmbajt fare kërkesave të Dosjes së Tenderit dhe nuk ka pasqyruar asnjë provë apo argument të qëndrueshëm rreth konstatimeve të tij.

Paneli Shqyrtues, konsideron se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, Lidhur me pretendimin ankimore qe ka te beje me importin e produktit te sulfurit dhe vendimin e AK-së për anulimin e aktivitetit te prokurimit, Paneli shqyrtues sqaron se kërkesë te dosjes se tenderit është: "*Largimi i zvarranikëve – Për kryerjen e këtij shërbimi të përdoret njëri lloj i këtyre aparateve apo vetëm granulat. 1 - Aparate me vibrim për dëbimin e zvarranikëve me bateri që vendosen në tokë. - Sipërfaqja 300 - 400 m² për largimin e Zvarranikeve, të qëndrueshëm ndaj lagështisë. ose 2 –Aparate solare me vibrim për dëbimin e zvarranikëve që vendosen në tokë. - Sipërfaqja 600 – 700 m² për largimin e Zvarranikëve të qëndrueshëm ndaj lagështisë. 3 – Preparate repelente ekologjike si granula për largimin e zvarranikëve me efektivitet optimal",* referuar Aneksit 1 te dosjes se tenderit "Lejohet për përdorim edhe preparati ekuivalent me efekt te njëjtë" pjesa e specifikimit teknik për "largimi i zvarranikeve" të njëjtat janë bazuar neni 28 paragrafi 7 të LPP-në, pasi qe kjo u konstatua edhe ne seancen degjimore, ku AK, palet ne ankese dhe eksperti shqyrtues sqaruan se specifikimet teknike jane ne pajtim me dispozitat ligjore te nenit 28 të LPP-së. Po ashtu Vlen te theksohet se ne dosje te tenderit nuk është kërkuar përmbajtja e produkteve apo "Safety Data Sheet" për produktet e ofruara nga OE pjesëmarrës ne aktivitet te prokurimit, duke pas parasysh përmbajtjet e produkteve dhe rrezikshmërinë e tyre për shëndetin publik per faktin se OE pjesëmarrës ne këtë aktivitet te prokurimit eshte kerkuar qe të posedojnë licencë për importin e këtyre produkteve. Për çështje të sigurisë së tyre në lidhje me origjinën e produkteve tenderuese dhe lejen për përdorim në RKS, duhet të paraqesë edhe lejen e importit të produkteve të lëshuar nga Ministria e Ambientit Hapësinor në Republikes se Kosoves. Sa i përket pjesës se pretendimit

të OE ankues që ka të bëjë me importin e produkteve biocide dhe sqarimit se a janë te ndaluara produktet sipas listës se zyrtareve te MMPH, ku AK me rastine e ri-vlerësimit përmes komunikimit zyrtar me zyrtaret e MMPH se produktet sipas "Material Safety Data Sheet" me nr ID 875-25b kanë ndryshuar ne përmbajtje te komponentëve te rrezikshme dhe se përqindjet e lejuara tani janë dukshëm me te ultë se me lejen e importit qe OE pjesëmarrës te aktivitetit te prokurimit kanë në posedim.OE ankues "DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K."- Prishtinë ne ofertën e tij ka ofruar produkt me përmbajtje te sulfurit 28%, pasi qe sipas *Vendimit për leje të importit nga MMPHI Nr.22/2940/-1-ZSP/411/22 Datë 15.06.2022*), vlen të ceket se në bazë të këtij vendimi për leje të importit edhe është bërë importimi i produktin po ashtu edhe nga e-mail i zyrtarit te MMPHI nuk thuhet se preparatet me substancë active te sulfurit janë të ndaluara, gjithashtu MMPHI i ka dhënë lejen e importit OE prandaj pretendimi i OE ankues, eshte pjeserisht i bazuar. Po ashtu, AK këtë duhet ta vërtetoj saktë dhe ta argumentoj shkresën e MMPHI sepse edhe për panelin shqyrtues ka kundërthënie në mes të shkresës së MMPHI dhe vazhdimi i licencave nga vet ky institucion. andaj AK – Policia e Kosoves me rastin e rivleresimit obligohet te konstatoj sakt me anë të komisionit vlerësues adekuat se keto preparate a lejohet te perdoren dhe keto OE a jane te licencuar nga institucionet kompetente permes lejeve per keto produkte, pasi qe ne këtë aktivitet te prokurimit është kërkuar qe të posedojnë licencë për importin e këtyre produkteve.

Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimin e OE ankues "S.V. Veterina" ne oferten e tij nuk ka ofruar produkte me permbajtje te perqindjes se sulfurit, kjo u sqaru ne senacen degjimore para panelit shqyrtues nga palet (autoriteti kontraktues, eksperti shqertues dhe OE ankues).Vlen te theksohet se ne dosje te tenderit nuk është kërkuar përmbajtja e produkteve apo "Safety Data Sheet" për produktet e ofruara nga OE pjesëmarrës ne aktivitet te prokurimit, si dhe askund ne shkresen zyrtare me zyrtaret e MMPH nuk konstatohet/argumentohet se keto produktet e ofruara nga ky OE nuk lejohen te perdoren ne Republiken e Kosoves, si dhe është me rëndësi qe të shpalosen edhe fakti se ky aktivitet i prokurimit është shpallur me 10.06.2022, dhe ne momentin e tenderimit nga OE pjesermarres ne kete aktivitet te prokurimit kane pasur licenca valide (me afat valid) dhe operatoret ekonomik gjate seancës dëgjimore konfirmuan se kanë vazhduar licencat nga institucionet kompetente dhe si prove kane dorëzuar përmes e-mail-i si prove materiale per panelin shqyrtues, (te cilat jane vazhduar nga institucionetet kompetente nga OE Safet Osmani BI (SV Veterina) – Leja për kryerjen e shërbimeve DDD nga Departamenti i politikave Bujqësorë dhe Tregtisë me nr. **04.5-54/23 i vazhduar nga datës 20.01.2023.** Licenca e MMPHI për import te produkteve biocide me **nr 22/226/-1-ZSP e vazhduar nga data: 17.07.2023**), prandaj pretendimi i OE ankues konsiderohet i bazuar në këtë pikë.

Paneli Shqyrtues konsideron që aktiviteti i prokurimit në ketë rast t'i nënshtrohet procesit të rivlerësimit për ti përmbushur qëllimet parësore të LPP, sikurse sanksionohen ato me nenin 1, të Ligjit të cituar duke vlerësuar rrethanat dhe argumentet e paraqitura nga palët paneli nuk ka arritur të gjejë mbështetje të plotë në raport te ekspertit shqyrtues, andaj Paneli Shqyrtues vjen ne perfundim se ekzamnimi, vleresimi dhe krahasimi i tendereve nuk eshte bërë ne pajtim te plote me dispozitat ligjore te nenit 59 te LPP-se, si dhe është anuluar në kundërshtim me paragrafët e nenit 62 të LPP-së, ku thuhet: *1. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:1.1. një shkeljeje të ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të*

prokurimit", po ashtu dhe AK *nuk ka vepruar ne pajtim* me nenin 43.5 të Rregullores nr. 001/2022 per Prokurim Publik ,po citoj: **"**-Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave duhet të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme: a. asnjë tender nuk është paraqitur brenda afatit të specifikuar; b. asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm;".

Gjithashtu, Paneli shqyrtues konsideron se OE "S.V. Veterina" është eliminuar me arsyetimin se nuk e ka plotësuar kërkesën e DT, sa i përket referencave të cilat nuk janë të nënshkruara dhe nuk janë të vulosura dhe disa kontrata të punëtorëve, nenet përmbajnë gabime dhe janë kontradiktore njëra me tjetrën. Sa i përket asaj se nuk ka qenë kërkesë e Dosjes së Tenderit që këto referenca të jenë të nënshkruara dhe të vulosura. Nisur nga fakti se çdo dokument i cili lëshohet nga një palë në drejtim të palës tjetër në formë fizike me qëllim që të jetë i pranueshëm ai dokument së paku duhet të bëhet nënshkrimi i tij nga pala që e lëshon, kjo nuk është e qëndrueshme, por nisur nga fakti se ky aktivitet i prokurimit kthehet në ri-vlersim, atëherë, nga ky aspekt PSH i jep të drejtë ankuesit pasi që OE punëtorët i ka punëtor të kompanisë së tij dhe referencat lëshohen pas një kontrate apo aktiviteti të kryer më herët, kështu që këto punë të përfunduara mund të verifikohen përmes sqarimeve shtesë dhe kjo të bëhet në fazën e ri-vlerësimit dhe konform nenit 59.2 dhe 72 te LPP-së, pasi qe keto prova dhe fakte u prezantuan edhe para panelit shqyrtues duke u prezantuar lista e punëtoreve te nxjerra nga EDI deklarimi ATK, që dëshmon dhe argumenton se punëtoret e prezantuar ne listen me rastin e tenderimit ne ketë aktivitet te prokurimit jane punëtorë te per te cilët i ka te deklaruar ne ATK dhe jane punëtor te operatorit ekonomik OE "S.V.Veterina" .

Paneli Shqyrtues me fjale tjera konsideron se AK nuk ka ri-vlerësuar, ekzaminuar dhe krahasuar drejtë ofertat e operatoreve ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, si dhe nuk e ka respektuar nenin 7 paragrafi 2 të LPP-së, po citoj: *"Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatoreve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik*" si dhe neni 59 par. 4 të LPP-së, po citoj: *"Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit",* duke ju përmbajt kritereve tërësisht juridike qe lidhen me kërkesat e njoftimit per kontratë dhe dosjes se tenderit duke respektuar kriteret e dhënies, tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët, si dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-se. Andaj paneli marr parasysh natyrën e ndjeshme të këtij aktivitet konsideron që ky aktivitet duhet të kthehet sërish në ri-vlerësim meqenëse sipas vendimit paraprak Nr. 2023/0283, 2023/292 i dt: 24.07.2023, nuk ishte themeluar fare komision vlerësimi, andaj me qëllim të vërtetimit të drejt paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet të këtë ne konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

Paneli Shqyrtues kërkon nga AK që të njëjtit të jenë të vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik në të ardhmen duke respektuar në përpikëri Ligjin e Prokurimit Publik dhe rregullat e zbatueshme, dhe po ashtu urdhëron të njëjtit të veprojnë në harmoni me rekomandimet e dhëna në këtë vendim, në të kundërtën Organi Shqyrtues i Prokurimit nga

kuadri i Paneleve Shqyrtuese, ka të drejtë të kërkoj ndërmarrjen e masave disiplinore ndaj zyrtarëve përgjegjës të prokurimit.

Pas analizimit te shkresave te lartpërmendura te cilat i kishte ne dispozicion Paneli Shqyrtues, si: Ankesat e OE-ve ankues, raportet e ekspertit shqyrtues, vendimin e PSH. Nr. 2023/0283, 2023/292 i dt: 24.07.2023, si dhe duke marr per baze dispozitat ligjore te LPP-se, dihet mire se vendimet e OSHP-se jane te detyrueshme per autoritetin kontraktues dhe te gjitha palët ne procedure dhe se kundër vendimeve te OSHP-se, palët mund te ankohen ne gjykatën kompetente brenda afatit ligjore me mjete te rregullta juridike, ne përputhje me këshillën juridike te dhëne ne ketë vendim. Po ashtu, vlenë të theksohet se AK vendimet paraprake për këtë lëndë nuk i ka kuptuar qartë, sepse detyrë eksplicite e tyre ka qenë që të vërtetohet që Dosja e përmban elemente/ specifika që janë në kundërshtim me rregulloret në fuqi dhe me rregulloret e BE. Ku në seancën e mbajtur deklaruan se Dosja e Tenderit është në rregull. Kështu që për panelin shqyrtues kjo bi ndesh me nenin 62 të LPP.

-Përfundim -

Paneli shqyrtues konsideron se pohimet ankimore janë të bazuar, sikurse është shpjeguar dhe si më sipër, kurse AK nuk ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 1, 6, 7, 59 dhe 62 të LPP. Kthimi i një aktiviteti të prokurimit në ri-vlerësim, me fakte dhe prova kontestuese dhe/ose me bazë ligjore, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "*...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji*"

Andaj nga te lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **POLICIA E KOSOVËS, POLICIA E KOSOVËS**
- OE - **DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K., S.V.„Veterina**
- Arkivës së OSHP-së: